



INTERREG III A ITALI-SHQIPERI
2000-2006
“BiblioDoc-Inn”



Shkodra në fokus

Shtator – Dhjetor 2005

Redaktim

INTERREG III ITALI-SHQIPERI

Treguesi

Redaktorë da: **Marsida Tahja, Miriam Taipi, Orjeta Baja, Shpresa Rusi**

Përkthyes: **Admir Alija**

Perpunimi dixhital: **Valter Messori**


Konsulente: **Daniela A. Lo Martire**

Partner: [Shoqata kulturore Iride](#)



Në kopertinë porteti i Marin Barletit. Një ndr humanist më të shquar shqiptare të shek. XV. Një prift katolik me kulturë të lartë, ka jetuar gjatë gjysmës së dytë të shek. XV dhe gjatë 15 viteve të para të shek. XVI, ka luftuar për mbrojtjen e qytetit të Shkodrës. Më 14 Prill 1467 shkon në Venedik e më pas në Romë ku shkruan veprat e mëposhtme:

1. “De obsidione Scodrensi” publikuar në Venedik më 1504;
2. “Historia e Skënderbeut” publikuar në Roma midis 1508 e 1510;
3. “Compendium vitarum summorum pontificium imperatorumque Romanorum”



INTERREG III ITALI-SHQIPERI¹

“Promovimi dhe zhvillimi i modeleve inovative të bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave dhe qendrave të dokumentimit italo-shqiptare” (BiblioDoc-Inn)

Aksi IV – Mizura 4.1 – Aksioni 4 – Nën Aksioni 4.1

Financuar nga Bashkimi Europian, projekti shënon arritje në drejtim të bashkëpunimit institucional të bibliotekave shqiptare me ato italiane. Ai promovon forma të bashkëpunimit ndërrajonal, krijon mundësira të njohjes së kulturave të dy popujve, të integritit të bibliotekave shqiptare në rrjedhën e atyre europiane. Në këtë projekt janë përfshirë Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, biblioteka publike “Qemal Baholli” e qytetit të Elbasanit dhe biblioteka publike “Marin Barleti” e qytetit të Shkodrës.

Projekti synon arritjen e objektivave të tillë si:

- Zbatimin e të drejtës për akses në informacion, të garantuara nga Bashkimi Europian, në dobi të qytetarëve në përgjithësi;
- Lehtësimin e procesit të integritit europian përmes një informacioni të saktë mbi probleme të bashkësisë me interes të veçantë për bashkëpunimin ndërkufitar;
- Zvogëlimin e “dallimeve digjitale” përmes zbatimit të shpërndarjes së teknologjisë infotelematike në administrimin publik në dobi të zonave më të prapambetura;
- Promovimin e trashëgimisë biblio-dokumentare në përgjithësi, veçanërisht asaj të përcaktuar si vlerë kulturore;
- Modernizimin në planin e administrimit, përmirësimin cilësor dhe rritjen e shërbimeve publike.

Për arritjen e këtyre objektivave projekti parashikon realizimin e një programi për hartimin e buletineve tematike periodike dygjuhëshe, kryesisht për konsultim në www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn.htm, por edhe për konvertim në letër në përshtatje me shërbimet tradicionale të bibliotekave të përfshira në projekt; si edhe realizimin e një programi për hartimin e botimeve profesionale.

¹ Në konferencën e mbajtur në Bari më 11-12 tetor të vitit 2001 në kuadër të INTERREG II, u vu në dukje gjendja e vështirë e bibliotekave publike në Shqipëri. Rruga më e sigurtë dhe më efektive për rritjen e bashkëpunimit dhe përmirësimin e drejtimit bibliotekar është përfshirja e drejtpërdrejtë e disa bibliotekave publike dhe qendrave shqiptare të dokumentacionit në struktura-pilot përmes të cilave të pasqyrohen risitë dhe të konsolidohen në territorin shqiptar modele që nxitin zhvillim në këtë fushë.

TREGUESI

Tradita e bibliotekave në Shkodër

Bibliotekat e Universitetit dhe Muzeut të Shkodrës

Bibliotekat E Enteve Fetare (e Myftinisë, e Jezuitëve dhe e Françeskanëve)

Biblioteka E Myftisë Së Tabakëve (Këllyçi)

Bibliotekat E Shoqërive Deri Ne Vitin 1944

Biblioteka Publike "Marin Barleti" Shkodër

Bibliotekat e sotme private dhe shkollore

Problemet aktuale mbi bibliotekat

Tradita e bibliotekave në Shkodër

G. Çuni – V.Osja, *Fondet albanologjike në bibliotekat e Shkodrës*, "Studime shqiptare 12", Shkodër 2003, fq. 224-233, vendndodhja: [Al 14 – 50 B]

G. Çuni, *Historiku u librit në Shkodër deri në vitin 1944*, "Shkodra në shekuj" 4/4, fq. 259-267, vendndodhja: [Al 15 – 12 B]

Bibliotekat e Shqipërisë, Tiranë 1998, vendndodhja: [Al 15 – 12 B]

H. Bushati, "Shkodra dhe motet", vol. II, *Shkodër 1999*, fq.115, vendndodhja: [S 68 – 4 D]

Bardhyli, *Historia e bibliotekave në Shkodër*, "Hylli i dritës", 1942, nr. 2, fq. 218, vendndodhja: [Al 19 – 1 D]

Grup autorësh, *Kontribut për historinë e bibliotekave në Shkodër*, Shkodra,1961, fq. 95-118. vendndodhja: [Pm 13 – 13 D]

Grup autorësh, "Historiku i bibliotekave në Shkodër", 1961, fq. 61, vendndodhja: [Al 15 –10C]

W. Kamsi, "Bibliotekat në traditën kulturore të Shkodrës" - kumtesë e mbajtur në Akademia e Shkencave, janar 2003, vendndodhja: [Al 15 – 15 C]

V. Osja, *Libri dhe bibliotekat në Shkodër*, "Shkodra në shekuj", nëntor 2000, fq. 335-341, vendndodhja: [P sh 10 – 20 D]

Historia e qytetit të Shkodrës dhe kultura e saj, është e pandarë nga historia e librit dhe prania e bibliotekave në këtë qytet. Mbështetur në traditat kulturore dhe të shkrimtarëve të saj, Shkodra është quajtur *vatra e kulturës dhe e librit*. Me fillimet e botimeve të para në gjuhën shqipe të shek. XVI dhe përpjekjet për ngritjen e shkollave fetare, u krijuan edhe qendra të grumbullimit e ruajtjes së librave. Pjetër Bogdani në veprën e tij "Çeta e profetëve" shkruan për përpjekjet e ungjit të tij për ngritjen e bibliotekës dhe ruajtjen e librave të saj. Shënime të kohës dëshmojnë për ekzistencën e shumë bibliotekave të pasura, falë dëshirës e kulturës së disa familjeve shkodrane, siç ishte p.sh. ajo e Tabakëve, apo mjaft të tjera të përmendura më poshtë, të cilat, krahas atyre të institucioneve fetare, do shërbenin si baza të bibliotekave publike të krijuara më vonë në Shqipëri. Në një studim të bërë nga një grup autorësh në vitin 1966, rezultoi të kenë qenë 28 biblioteka me karakter albanologjik, por në një studim të hulumtuesit Eilily Kamsi, numri i tyre është më i madh, gjë që tregon se nuk njihet i saktë.

Në një renditje kronologjike, bibliotekat më të spikatura, me karakter albanologjik janë:

1683 Biblioteka Bogdani (biblioteka e parë e dokumentuar e Shkodrës)

1750 Biblioteka e Myftisë së Tabakëve apo Këllyçi

1834 Biblioteka e Vakëfit

1858 Biblioteka e Etërve Jezuitë

1875 Biblioteka e Etërve Françeskanë

1899 Biblioteka e shoqërisë "Bashkimi"

1901 Biblioteka e shoqërisë "Agimi"

1911 Biblioteka e klubit "Gjuha shqype"

1916 Biblioteka e "Komisës Letrare"

1919 Biblioteka e shoqërisë "Vllaznia"

Ndër *bibliotekat private* të asaj kohe në Shkodër, po kujtojmë disa prej tyre:

- biblioteka e vëllezërve Ivanaj, e themeluar pas Kongresit të Lushnjës, ku dispononte një numër të konsiderueshëm librash, kryesisht juridik (blerë nga një jurist i huaj);

- biblioteka e Mustafa Pashë Bushatit, ku sipas M.Qafëzezit dhe Bardhytit (Llukë Karafilit), ajo vlerësohet si shumë e mirë, me libra frëngjisht e turqisht. Kjo bibliotekë, më vonë i është falur Vakëfit nga vetë pronari i saj;

- biblioteka e Llukë Karafilit (Bardhyli) me 2 500 vëllime në gjuhët: shqipe, greke, italiane, frënge, me përmbajtje letrare, historike, pedagogjike, vepra albanologjike e ballkanologjike, si dhe mjaft

dorëshkrime. Një bibliotekë tjetër private shumë e rëndësishme e qytetit tonë ishte dhe është ajo e Jup Kastratit, me një fond shumë të konsiderueshëm vëllimesh: libra, broshura, revista, etj., kryesisht me përmbajtje gjuhësore dhe letrare rreth albanologjisë; në gjuhët: shqip, italisht, frëngjisht, gjermanisht etj. Fondi i këtyre bibliotekave pasqyronte nivelin intelektual të kohës, prirjet dhe dëshirat e tyre. Më vonë, një pjesë e këtyre bibliotekave private u bënë bazë për bibliotekën publike të Shkodrës e Tiranës, me dëshirën e vetë familjarëve duke i dhuruar, duke i shitur, apo në disa raste edhe si pasojë e konfiskimit. Më 10 dhjetor 1922 u themelua Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, ku si bërthamë e saj shërbeu biblioteka e "Komisës Letrare Shqipe" (e krijuar në Shkodër në vitin 1916 me drejtues Hilë Mosin), së bashku me trashëgiminë e shoqërisë "Vllaznia" (me 3.000 vëllime). Fondi i ardhur nga Shkodra ishte 6 000 libra. Drejtor i saj do të caktohej Karl Gurakuqi. Përsa i përket vlerave albanologjike të këtyre bibliotekave, vlen të përmendet se këto biblioteka kanë qenë të specializuara. Ato kanë mbajtur jo vetëm libra, por edhe mjaft dorëshkrime e letërkëmbime me vlera të mirëfillta albanologjike, siç është p.sh. letërkëmbimi i Mjedës me albanologun e shquar austriak, Gustav Majer, *mbi probleme të gjuhës shqipe*. Këto biblioteka, që sot, i quajmë *biblioteka të traditës*, janë drejtuar nga njerëz të nderuar, të ditur e të shquar të Shkodrës, si: M. Pashë Bushatliu – hartuesi i statusit të parë të bibliotekave në Shqipëri -, H.Mosi, Gj. Fishta, H. Bushati, T. Kakarriqi, K.Kamsi, J.Kastrati etj.

[Treguesi](#)

Bibliotekat e Universitetit dhe Muzeut të Shkodrës

Gj. Çuni – V.Osja, *Fondet albanologjike në bibliotekat e Shkodrës*, "Studime shqiptare 12", Shkodër 2003, fq.224-233, vendndodhja: [Al 14 – 50 B]

V. Osja, *Libri dhe bibliotekat në Shkodër*, "Shkodra në shekuj", nëntor 2000, fq. 335-341, vendndodhja: [P sh 10 – 20 D]

W. Kamsi, "Bibliotekat në traditën kulturore të Shkodrës", - kumtesë e mbajtur në Akademia e Shkencave, janar 2003, vendndodhja: [Al 15 – 15 C]

Biblioteka e Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës filloi veprimtarinë e saj në vitin 1957 me një fond prej 1000 vëllimesh, të krijuara si rezultat i dy prurjeve:

- nga shitja e bibliotekave private të familjeve të vjetra shkodrane;

- nga librat më të zgjedhur të fondit të bibliotekës së çmuar të Llukë Karafililit (Bardhyli). Sot, ajo numëron rreth 150.000 vëllime, libra e materiale të tjera në shqip e në gjuhë të huaja (përfshirë këtu edhe bibliotekat e departamenteve). Është një nga 6 bibliotekat më të pasura në Shqipëri. Në përbërje të fondit të saj është literatura që mbështet degët e këtij universiteti në shërbim të procesit mësimor, sidomos degët shoqërore, por që kohët e fundit, me hyrjet e reja po anon nga shkencat natyrore. Shtimi i madh i numrit ka ardhur si rezultat i dhurimit dhe blerjeve të vazhdueshme nga institucioni. Kjo bibliotekë dallohet për fondin albano-ballkanologjik e të librave të rrallë që ajo ruan, kopje unike që nuk i ka as Biblioteka e Tiranës në fondet e veta. Ndër to vlen të përmenden botime të shek. XVI, siç është "Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis" e Marin Barletit botuar më 1508-1510 në Romë, "Rrethimi i Shkodrës" botuar në Frankfurt – 1578, si dhe botime të shek. XVII-XIX, siç është kopja unike që ruan kjo Bibliotekë: "Përmbledhje e shkurtër e doktrinës së krishterë" - 1740 e Gjon Nikollë Kazazit, "Doktrina e krishtenë" e Budit, "Gramatika e da Leces" - 1716. Gjithashtu, në këtë bibliotekë, gjendet koleksioni i plotë i revistave "Albania" të Faik Konicës, "Hylli i dritës" (1913-1944), Leka (1929-1944). Fondi albano-ballkanologjik përbën një pjesë të mirë të pasurisë së kësaj biblioteke, si më i veçanti dhe më i miri në Shqipëri. Ky fond përbëhet prej 10.000 volume librash e shtypi periodik. Një pjesë e këtij fondi është marrë nga biblioteka e Theodor Ippen-it dhe një pjesë, nga biblioteka e pasur e Lec Harapit. Në fondin e saj gjenden mjaft studime të rëndësishme të albanologëve të huaj për Shqipërinë dhe Ballkanin. Kjo bibliotekë, nga "Bibliotekë universitare", është kthyer edhe në "Bibliotekë publike".

Biblioteka e Muzeut të Shkodrës u themelua në vitin 1946, së bashku me themelimin e tij. Fondi i saj është krijuar nga tri prurje:

- nga fondi i bibliotekave jezuite dhe franceskane;

- nga bibliotekat personale të qytetarëve;

- nga një pjesë e botimeve të pas 46-ës.

Fondi i kësaj biblioteke arrin numrin 15 000 vëllime. Seksionet që spikasin janë, ai: historik, gjuhësor, arkeologjik, numizmatik etj. Një pasuri të veçantë të kësaj biblioteke përbën fondi që i dhuroi familja Pipa kësaj biblioteke. Afër dy vjet para se të vdiste, Arshi Pipa sikur ta ndiente, u kujdes që t'i dërgohej pasuria e tij e vetme, biblioteka, që kishte vënë me sakrificë e kursime në Shkodër, në Muzeun Historik të qytetit të tij. Fondi i tij përmban rreth 2.500 vëllime, të karakterit albanologjik, kritikë letrare, letërsi e huaj, filozofi, enciklopedi, koleksione të plota të revistës "Albania" të Faik Konicës dhe "Shenjëzat" e Ernest Koliqit, bibliografi, trajtesa albano-ballkanologjike, libra të së drejtës civile e penale, libra ekonomikë, libra italisht - 591 tituj, autorët francezë me 121 tituj, botimet e tij, dorëshkrimet ende të pabotuara, mjaft incizime me kaseta etj.

Bibliotekat E Enteve Fetare (e Myftinisë, e Jezuitëve dhe e Françeskanëve)

H. Bushati, "Shkodra dhe Mote" v. II, Shkodër, 1999, *Biblioteka e Vakëfit të Shkodrës*, fq. 97 – 101, vendndodhji: [S 68 / 4D].

Grup autorësh, "Shkodra", 1961, Shkodër 1961, *Kontribut për historinë e bibliotekave në Shkodër*, fq. 95 – 106, vendndodhji: [Psh 13 / 7D]

Bardhyli, "Hylli i Dritës", 1942, nr 5 – 10, *Historia e bibliotekave në Shkodër*, fq. 315, vendndodhji: [nr. 1 – 12]

K. Jup, "Buletini i shkencave shoqërore", 1955, *Mbi bibliotekën Këllyçi*, fq. 218, vendndodhji: [Psh 30 / 7 A]

F. Filip, "Shkëndia", 1941, Biblioteka e Myftisë së Tabakëve në Shkodër, fq. 61, vendndodhji: [AL 38/30 A]

W. Kamsi, *Dialogu sot = Dialogo oggi*, Qershor-Korrik, 2005, f. 90-91. Periodiku.

Biblioteka E Vakëfit. Institucionet fetare gjatë konsolidimit krijuan edhe bibliotekat e tyre. Një ndër këto dhe më e vjetra konsiderohet Biblioteka e Vakëfit të Shkodrës, të cilën e themeloi Veziri Mehmet Pashë Plaku në fund të shekullit XVIII dhe erdhi duke u pasuruar nga pasardhësit e tij. Vlerat e kësaj biblioteke evidentohen edhe nga studiuesi anglez Urquard në veprën e tij dyvëllimëshe "T. Ev. Spirit of Ther East". Kjo bibliotekë ishte e pasur jo vetëm për nga numri i madh i vëllimeve që dispononte, por edhe nga përmbajtja e tyre. Ajo kishte shumë vëllime që i përkisnin shkencave *filozofike, fetare, shoqërore e natyrore*; vepra filozofike të autorëve, si: Ibni Sina (Aviçena), Ibni Ruzhdi (Averroë), Imam Gazali, Fahrudin Rrazi, Majhuddin Arabi etj. Kjo bibliotekë zotëronte edhe libra të rrallë të botës orientale, si: "Historia e Ibni Halëdunit" - përkthyer në turqisht, "Historia e Xhevdet Pashes" - 12 volume, "Tahiri Taberi", dy koleksionet e përkthimeve shqip të "Kurani" - përpunuar nga H. Dalliu etj. Të gjithë librat vuloseshin me vulë personale të Mustafa Pashës, e cila kishte vitin 1834. Përveç këtyre, në bibliotekë kishte libra edhe të Karamahmut Pashës, me vulën e tij të vitit 1796, gjë që tregon vjetërsinë e kësaj biblioteke. Për vlerat e mëdha të kësaj biblioteke flet edhe fakti që, kur në vitin 1929 disa orientalistë gjermanë patën ardhur për ta vizituar atë, gjatë vizitës së tyre, ato dalluan disa libra të rrallë shkencorë që iu nevojiteshin atyre e që nuk i kishin gjetur në bibliotekat e tjera. Këto libra, ato dëshironin t'i blinin me çmime shumë të larta, por kjo kërkesë nuk u pranua nga administrata e Zyrës së Vakëfit, nga e cila varej biblioteka. Para 70 vjetësh, kjo bibliotekë filloi dekadencën nga moszbatimi i rregullores së bibliotekës nga vetë funksionarët e Kryemyftinisë. Biblioteka të tjera të Institucioneve fetare islame janë: *Biblioteka e Medrezes së Naltë pranë Kalasë, Biblioteka e Myftinisë dhe e Xhamisë së madhe në Pazar*, e cila përmendet edhe nga Sami Frasheri në librin "Kamus – ul Aalam".

Biblioteka E Jezuitëve. Jezuitët, të karakterizuar nga dashuria për kulturën dhe dëshirën për studime, themeluan bibliotekën e tyre në vitin 1.858. Kjo bibliotekë u pasurua shumë dhe arriti të kishte në fondet e saj – 13.500 vëllime të natyrave të ndryshme, si: vepra asketike, vepra të botuara nga jezuitët, letërsi latine, letërsi greke, enciklopedi, revista shkencore, shkrime shenjte, filozofi, apologjetikë, elokuencë etj. Kjo bibliotekë kishte edhe seksionin e librave shqip. Në këte bibliotekë gjendeshin: "Çeta e Profetëve" e Bogdanit e edicionit të parë të Padovës të vitit 1683, "Jeta anonime e Skenderbeut" (Venedik 1646), "Iliricum Sacrum" e Farlatit, "Gramatika e moçme shqipe" e A. Rossi nga Montalba - O F M (Romë 1716), "Studime Albanologjike" të Mayerit, të Ascolit, Hanit, Yoklit etj.

Në këtë bibliotekë gjendeshin libra në gjuhën shqipe, të botuar në të gjitha shtypshkronjat brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe të gjithë librat e botuar prej jezuitëve shqiptarë. Këtu gjendeshin shumë libra të botuar në gjuhë të ndryshme, që flasin për Shqipërinë. Ndodheshin gjithashtu edhe fotografi dhe kopje dokumentesh historike të mbledhura në arkivat e shteteve të ndryshme, që lidhen me historinë e Shqipërisë dhe që nuk janë botuar deri më sot. Kjo bibliotekë ruante edhe dorëshkrimet e Etërve:

Junku, Zanoni, Bazhdari, Dom Ndre Mjedës etj. Këtu gjendej gjithashtu edhe një koleksion me vlerë hartash gjeografike.

Biblioteka E Françeskanëve. Deri në Luftën e Dytë Botërore, kjo bibliotekë mendohet të ketë qenë më e madhja në Shkodër me – 30.000 volume. Kjo bibliotekë është themeluar në vitin 1.875 dhe ka pasur shumë libra me përmbajtje pedagogjike, filozofike, të shkencave shoqërore, të letërsisë antike, të teologjisë, shkrime shenjte, enciklopedi, fjalorë etj. Kjo bibliotekë ka pasur enciklopeditë” Treccani” (37 volume), ”Larousse” (17 volume), ”Staatslexikon“ (27 volume), ”Herders Konversations Lexikon”, Ëaddingus ”Annales Minorum” (27 volume) etj. Këtu ruheshin dorëshkrimet e Gj. Fishtës, Sh. Gjeçovit e të shkrimtarëve të tjerë françeskanë, si edhe fotokopja e ”Mesharit” të Buzukut (1555). Françeskanët kanë pasur edhe bibliotekën e Shkollës Françeskane, të themeluar në vitin 1861, si dhe një bibliotekë tjetër tek kisha e Arrës së Madhe.

Rikrijimi I Bibliotekave. Pas shkatërrimeve që pësuan bibliotekat pas mbylljes së institucioneve fetare, në ditët tona, këto biblioteka kanë rifilluar veprimtarinë e tyre nën kujdesin e instucioneve fetare dhe të urdhërave të ndryshëm. Pranë Kryemyftinisë në Shkodër është krijuar përsëri biblioteka e Myftinisë. Po kështu, edhe pranë Seminarit Ndërdioqezan të Shkodrës është krijuar një bibliotekë e pasur albanologjike me 10.000 vëllime.

[Treguesi](#)

Biblioteka E Myftisë Së Tabakëve (Këllyçi)

F. Fishta, *Biblioteka e Myftinisë së Tabakajve në Shkodër*, "Shkëndija", 1941, nr 1, fq.16, Shtypshkronja: "Shkolla profesionale industriale – Tiranë, vëndndodhj: [Al 38/30A].

H. Bushati, "Shkodra dhe Motet" v. 2, Shkodër 1999, fq. 102, Shtypshkronja "Rozafat", vëndndodhj: [S 68/12 D].

J. Kastrati, "Bibliotekën Këllyçi". BSHSH, Tiranë, 1955, nr 2, fq. 218, vëndndodhj: [Psh 30/7 A].

Xh. Shkodra, *Biblioteka Këllyçi* (pjesa I), "Kultura Islame", nr 2, 1941, fq. 61, Shtypshkronja "Tirana", Tiranë, vëndndodhj: [Al 17/5 D].

Grup autorësh, *Kontribut për historinë e bibliotekave të Shkodrës*, Buletini "Shkodra", 1961, nr 1 vëndndodhj: [Psh 15/6A].

Biblioteka e Myftisë së Tabakëve (Këllyçi) është një nga bibliotekat më të vjetra e më të rëndësishme të vendit tonë, e cila u themelua rreth vitit 1750 nga Hasan Këllyçi. Atij iu desh një përgatitje e mirë që kjo bibliotekë të merrte përmasa vërtetë serioze. Mbas tij erdhën trashëgimtarë, të cilët e pasuruan edhe më tepër këtë bibliotekë, siç ishte Isuf Tabaku - i nipi i Hasan Këllyçit. Shtëpia ku ndodhej biblioteka e Myftisë së Tabakëve është një nga ndërtesat tipike të Shkodrës, me oborr te madh, dykatëshe, ku pranë çardakut dhe odës së miqve ishte dhoma e librave. Si bibliotekë e vjetër, ka ruajtur në gjirin e saj shumë dorëshkrime me rëndësi, si p.sh dorëshkrimin "Vehbije", i shkruar në dialekt kosovar nga Tahir Gjakova. Një pjesë e librave është kopjuar nga Isuf Tabaku. Ai ka shkruar edhe një libër dorëshkrimesh që përmban shumë ngjarje me rëndësi historike. Biblioteka Këllyçi përmban edhe dy tahte të Hoxha Tahsinit, tahte astronomike të botuara në Paris në vitin 1284. Gjithashtu, biblioteka përmban libra me këto lëndë: Interpretim të Kuranit, Fjalë profetike, Predikime, Teologji, Filozofi, Literatura, Retorikë, Sintaksë, Histori, Kimi, Matematikë, Gjeografi etj. Jup Kastrati në diskutimin e tij për bibliotekën Këllyçi, shprehu bindjen se në atë thesar dorëshkrimesh të pastuduara deri tani, duhet të gjenden mjaft materiale ose informacione, sidomos rreth bejtexhinjëve. Prandaj propozoi që ky material kaq i rëndësishëm duhet të kontrollohet e të studiohet sa më parë. Zjarret e rëna në periudha të ndryshme kanë dëmtuar pasuritë e kësaj biblioteke.

[Treguesi](#)

Bibliotekat E Shoqërive Deri Ne Vitin 1944

Bardhyli, *Historia e Biblitekave në Shqipëri*, "Hylli i Dritës", 1942, nr 5-10, fq 314-318, vendndodhj: [Al 18/7 F].

Xh. Shkodra, "Kultura Islama", *Biblioteka Këllyçi*, nr 2, fq. 63, Shtypshkronja "Tirana" Tiranë, vendndodhj: [Al 17/5 D].

Gj. Cuni, *Historia e librit në Shkodër deri në vitin 1944*, "Shkodra në shekuj", vëll. IV, 2004, fq 259-266, Shtypshkronja "Rozafa 1" Shkodër, vendndodhj: [Al 15/12 B].

V. Osja, *Libri dhe bibliotekat në Shkodër*, "Shkodra në shekuj", vëll III, 2004, fq. 335-33, Shtypshkronja "Rozafa 1" Shkodër, vendndodhj: [Al 15/11 B].

I. Zamputi, *Cështje të shkrimit dhe të fillimit të letersisë në gjuhën shqipe "H. Dritës"*, 1995, nr 1-2, fq 27-33, vendndodhj: [Al 18/13 F].

J. Kastrioti, *Për një bibliografi shkencore albanologjike*, "Buletini i Bibliotekave" viti XXXIV, Nr 2. Tiranë, 1996, fq 14-15, vendndodhj: [BB 16 B]

A. Stipcevic, "Historia e Librit", Tiranë 2000, vendndodhj: [S 65/9 D].

Një rol të rëndësishëm në historinë e bibliotekave të Shkodrës zënë edhe bibliotekat e shoqërive:

1899 - Biblioteka e shoqërisë "Bashkimi";

1901 - Biblioteka e shoqërisë "Agimi";

1911 - Biblioteka e Klubit "Gjuha Jonë";

1917 - Biblioteka e "Komisarisë Letrare";

1919 - Biblioteka e shoqërisë "Vllaznia".

Biblioteka e Klubit "Gjuha Jonë" ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme në shpërndarjen e librit shqip, sidomos të teksteve shkollore.

Fondi albanologjik i bibliotekës së "Komisarisë Letrare", së bashku me trashëgiminë e bibliotekës së shoqërisë "Vllaznia" (rreth 3.000 vëllime), do të shërbente për të krijuar më 1922, Bibliotekën Kombëtare, drejtor i së cilës do të caktohej Karl Gurakuqi. Me mjaft rëndësi për qytetin tonë ishte nisma e studentëve shkodranë që studionin jashtë shtetit për ripërtëritjen e Bibliotekës Popullore në Shkodër (Biblioteka e Bashkisë), e krijuar rreth vitit 1931, me nismën e shoqërisë "Besa Shqiptare". Këto biblioteka të krijuara në Shkodër ishin frut i një pune të palodhur të njerëzve të ditur të Shkodrës, ku mund të përmendim: Hilë Mosin, vëllezërit Gjylbegaj, vëllezërit Ivanaj, vëllezërit Kamsi, etj., të cilët padyshim, jo vetëm krijuan dhe mirëmbajtën këto biblioteka, por hodhën edhe bazat e një biblioteke ekonomie kombëtare.

[Treguesi](#)

Biblioteka Publike "Marin Barleti" Shkodër

T.Osmani, "Komisia Letrare Shqipe në Shkodër" (1916 – 1918), Shkodër, 2004, fq. 91 - 92, vendndodhj: [S 100 / 4 B].

Grup autorësh, "Shkodra" 1961, Shkodër 1961, *Kontribut për historinë e bibliotekave në Shkodër*, fq. 95 – 118, vendndodhj: [P. Sh. 13/7D].

J. Kastrati, *Për një bibliografi shkencore albanologjike*, "Buletini i bibliotekave", 1995.

A. Parruca, "Shkodra bastion i qytetërimit shqiptar", Tiranë, 2002, fq.50, vendndodhj: [S 57/24 C]

M. Dibra, "Shkodra, Guidë album", vendndodhj: [S 105/23 B]

Nga gjurmimet e deritanishme të studiuesve del se historia e bibliotekave të Shkodrës zë fill me bibliotekat e njerëzve të shquar në veprimtaritë letrare, fetare, historike, patriotike e politike të Shkodrës e të Shqipërisë. Si vit i krijimit të bibliotekës publike (popullore) të Shkodrës merret viti 1931, me selinë e saj pranë Lulishtes Popullore. Por, në fakt, biblioteka e parë në Shkodër u themelua nga Komisia Letrare më 16 prill 1917, dhe kjo bibliotekë, selinë e saj e kishte në lagjen Parrucë. Përgjegjës i parë i saj ishte Kolë Kamsi. Biblioteka e Shtetit (siç u emertua atëherë), fondet e saj të para i krijoi me librat e dhuruar nga shoqëria letrare – artistike "Vllaznia", si dhe nga dhuratat e qytetarëve të Shkodrës. Në vitet e para, fondet e kësaj biblioteke nuk i kalonin 2500 vëllimet dhe frekuentimi ditor ishte mesatarisht 40 vetë, të cilët ishin kryesisht nxënës. Në vitin 1945, me mbylljen e institucioneve shtetërore dhe private të paraluftes, si dhe në vitin 1968 të institucioneve fetare, një sasi e madhe librash pasuroi fondin e Bibliotekës "Marin Barleti", e cila në vitet e pasluftes, selinë e vet e kishte tek ish - godina e Muzeut të Shtetit, dhe më vonë, aty ku ndodhet Bashkia sot, deri në vitin 1968, vit në të cilin u ndërtua godina e re, ku ndodhet edhe sot. Biblioteka "Marin Barleti", përveç pasurimit të saj me një pjesë të librave të institucioneve fetare, kryesisht të Françeskanëve dhe Jezuitëve, vjen duke u pasuruar çdo vit nga blerjet me fondet e caktuara nga buxheti i shteti, si dhe me dhurata të institucioneve dhe individëve të ndryshëm. Buxheti i caktuar nga Bashkia Shkodër - në vartësi të së cilës ka kaluar këto vitet e fundit, për vitin 2005 është 2 000 000 lekë. Ky buxhet përdoret për pasurimin e saj me libra dhe periodikë. Numri i titujve me të cilët është pasuruar vitet e fundit, është mesatarisht 400 në vit. Në fillim të vitit 2005, biblioteka publike "Marin Barleti" - Shkodër, në fondet e veta kishte - 220 000 vëllime e koleksione të ndarë sipas fondeve.

Fondi shqip ~ 70 000 vëllime

Arkivi i fondit shqip ~ 18 000 vëllime

Reparti i fëmijëve ~ 34 000 vëllime

Arkivi i rep. të fëmijëve ~ 2 000 vëllime

Reparti i periodikut ~ 24 000 koleksione

Fondi i perëndimit ~ 40 000 vëllime

Fondi tekniko – shkencor ~ 24 000 vëllime

Fondi i Albano – Balkanologjisë ~ 8 000 vëllime e koleksione

Fondi i hapur ~ 7 000 vëllime

Antikuarë ~ 2 000 vëllime

Inkunabula - 4 vëllime

Dorëshkrime - 154, si dhe shumë fjalor, enciklopedi, harta etj. Biblioteka ka në dispozicion të lexuesve këto katalogë me skedarë:

- Katalogë alfabetik (me autor dhe titull)

- Katalogë sistematik (sipas K. D. U.)

- Katalog topografik.

Struktura e bibliotekës është kjo:

1 - Drejtori

2 - Fondi shqip - 2 punonjëse

- 3 - Periodiku - 1 punonjëse
- 4 - Reparti i fëmijëve - 1 punonjëse
- 5 - Fondi i perendimit - 1 punonjëse
- 6 - Fondi i Albanologjise - 1 punonjëse
- 7 - Fondi i hapur - 1 punonjëse
- 8 - Restaurimi dhe lidhja e koleksioneve - 1 punonjëse
- 9 -1 pastruese

Në bibliotekë bëhen katalogët respektiv të treguar më lart.

Janë marrë masa për krijimin e një mikroklime të nevojshme për të krijuar kushte sa më të përshtatshme për lexim dhe studim me instalimin e një rrjeti prej 8 kondicionerësh. Gjithashtu, është krijuar infrastruktura e nevojshme për automatizimin me anën e instalimit të një rrjeti prej 9 kompjuterash. Kohët e fundit është instaluar edhe interneti, kjo, falë bashkëpunimit me Bibliotekën "Teca del Mediterraneo" të Barit, në kuadrin e projektit INTERREG III.

Gjithashtu, në kuadrin e këtij projekti, në bibliotekën "Marin Barleti" u hap edhe zyra Info- Point, ku u punësuan 2 punonjëse, dhe qëllimi i kësaj zyre është njohja e të rinjve shqiptarë me normat e Komunitetit Evropian për t'u integruar sa më lehtë në të. Objektivi tjetër i Bibliotekës në kuadrin e këtij programi, është njohja reciproke e bibliotekave të rajonit të Evropës Jug – Lindore, që po realizohet me nxjerrjen e buletineve nga 4 persona të punësuar pranë kësaj Biblioteke.

Biblioteka "Marin Barleti", përveç punës së saj rutinë, bën promovime librash, hap ekspozita materialesh bibliotekare, organizon biseda për libra me shkrimtarë etj.

[Treguesi](#)

Bibliotekat e sotme private dhe shkollore

"Shkenca dhe Jeta", viti i botimit, XIX, nr.3 (106), fq.26-27, 47, Tiranë 1987, vendndodhja: [Psh 10/18c].

V. Osja "Libri dhe bibliotekat në Shkodër", Shkodër, 2004, fq. 335-341, vendndodhja: [Al 15/2b].
Inventari i librave tek dokumentet arkivore që ndodhen në Drejtorinë e Bibliotekës.

Një shenjë e kulturës, zhvillimit dhe emancipimit të kombit janë edhe bibliotekat private:

Biblioteka e Jup Kastratit - një ndër më të pasurat sot për nga numri dhe vlera, është themeluar nga vetë profesor Kastrati më 1931. Sot, ka një bibliotekë albanologjike të specialitetit me rreth 10.000 tituj. Fondi përmbledh gjithë fjalorët e shqipes, që nga Bardhi (1635, fotokopjuar nga M.Rok), të gjitha gramatikat e shqipes, që nga ajo e Da Leçes (1716), vepra gjuhësore të dijetarëve shqiptarë dhe albanologëve të huaj, libra, broshura, revista etj., kryesisht me përmbajtje gjuhësore dhe letrare rreth albanologjisë në gjuhën shqipe dhe italisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht e vjetër, rumanisht, latinisht, rusisht etj; pothuajse të gjitha revistat më serioze të shqipes (në koleksione të plota), si edhe qindra fjalorë të gjuhëve të huaja dhe enciklopedi.

Biblioteka e Kolë Kamsit. Së pari, në këtë bibliotekë një vend të veçantë zënë librat që kanë të bëjnë me folklorin shqiptar, ku spikasin emrat e Z. Jubanit, M.Sirdanit, K. Taipit etj. Arbëreshët janë të pranishëm me vepra letrare e historike. Grup i veçantë është edhe ai i fjalorëve, gramatikave e librave të leximit, ku veçohen emrat e Jungut, Kristoforidhit, Busetinit etj. Kjo bibliotekë ka në fondin e vet rreth 3.200 libra dhe revista.

Biblioteka e Hasan Lekajt, një nga më të pasurat sot në Shkodër, themeluar më 1947, ku fondi i saj arrin 12.000 tituj. Biblioteka e ka mjaft të pasur seksionin e letërsisë kombëtare dhe asaj të huaj. Ka një numër të madh fjalorësh një gjuhe dhe dy e tri gjuhësh. Biblioteka është mjaft e pasur me fjalorët enciklopedikë në gjuhët sllave dhe frënge dhe libra të teorisë dhe kritikës letrare (të botuar jashtë), që përbëjnë një tjetër specifikë të kësaj biblioteke.

Biblioteka e Wlliy Kamsit. E themeluar nga i ati i tij, Gjon Kamsi, kjo bibliotekë në fillimet e saj do të kishte një karakter letrar në pas, sipas ineresave të krijuesit të saj, do të pasurohej me libra të karakterit ekonomik e tregtar (në gjuhët: shqip, italisht, frëngjisht). Me vlerë janë edhe librat e autorëve të huaj që flasin për Shqipërinë, si edhe revistat që botoheshin në atë kohë në Shkodër: "Hylli i Dritës" e "Leka". Kjo bibliotekë e trashëguar, do të pasurohej më tej nga Eilij Kamsi, me libra të karakterit letrar, historik, gjuhësor, si edhe me koleksione të plota të revistave "Studime historike", "Studime filologjike", libra të botuar në Kosovë etj. Mjaft i pasur është edhe fondi i fjalorëve shqip dhe dygjuhësh. Fondi i saj arrin mbi 2.000 tituj.

Biblioteka e Tomor Osmanit. Kjo bibliotekë numëron në fondin e saj rreth 5.000 tituj në gjuhët: shqipe, turke, arabe, italiane, frënge etj., si dhe vepra albanologjike, epistolarë, dorëshkrime, etj. Fjalorët dygjuhësh e pasurojnë mjaft bibliotekën.

Biblioteka e Ahmet Osjes. Kjo bibliotekë numëron një fond prej 5.000 vëllimesh të karaktereve të ndryshme. Në të gjenden mjaft fjalorë shqip, po kështu edhe fjalor dy e tri gjuhësh. Ka edhe libra të karakterit letrar, gjuhësor, historik, gjeografik etj. Fondin e bibliotekës e pasurojnë edhe librat në gjuhët italisht, frëngjisht, anglisht, spanjisht e rusisht.

Biblioteka e Tefë Topallit. Biblioteka mban një fond prej më se 10.000 vëllimesh. Biblioteka ka pasur një prirje të qartë drejt librit letrar dhe shkencor. Prania e literaturës psikologjike, mjekësore, pedagogjike, gjuhësore, fjalorët, që nga ai i Bashkimit, i Gazullit deri te fjalorët normativ të shqipes. Po këshu gjenden edhe fjalor dygjuhësh, fjalori normativ i gjuhës ruse të O.Zhegovit, si edhe enciklopedia italiane "Melzi". Mjaft e pasur biblioteka është edhe me periodikët e para dhe pas '45-sës. Si vlerë e fondit të kësaj biblioteke janë relacionet e shek. XVII, Rregjistri Kadasral i Shkodrës, si edhe Dokumentet e Venedikut për Shkodrën dhe Dejen (Danjen).

Biblioteka e Fondacionit Soros përmban një fond prej 2300 librash të fushave të ndryshme.

Në Shkodër, krahas bibliotekës qendrore funksionojnë dhe **biblioteka modeste pranë shkollave 9-vjeçare dhe të mesme:**

1. Biblioteka e shkollës "I.Qemali" mban një fond prej 7.801 librash letërsie shqipe. Nuk ka hyrje të reja.
2. Biblioteka e shkollës "Xh.FISHTA" mban një fond prej 1.057 librash letërsie shqipe. Ka hyrje të reja.
3. Biblioteka e shkollës "Disuria" mban një fond prej 50 librash letërsie shqipe për fëmijë; 40 libra shkencorë; 26 libra në gjuhë të huaj në gjuhët: anglisht, gjermanisht, italisht.
4. Biblioteka e shkollës "28 Nëntori" përmban një fond prej 6.400 librash letërsie artistike të autorëve shqiptarë dhe të huaj.
5. Biblioteka e shkollës "Shejnaze Juka" përmban një fond prej 4.000 librash, të ndarë këto në fondin shqip rreth 2.000 libra dhe në fondin e huaj, në gjuhët përkatëse frëngjisht, anglisht, italisht, gjermanisht, (rreth 2.000 libra).
6. Biblioteka e shkollës "Haxhi Sheh Shamia" përmban një fond mbi 4.000 librash, të ndarë këto në libra fetarë, shkencorë, didaktikë dhe letrarë.
7. Biblioteka e shkollës "Pjetër Mëshkalla" përmban një fond prej 7.000 kopjesh, të ndarë në pjesë, libri shqip dhe ai i huaj ku mbizotërojnë librat në gjuhën italiane. E veçanta e kësaj biblioteke është pasuria e saj me materialet referuese. Biblioteka mban 17 tituj enciklopedish.

[Treguesi](#)

Problemet aktuale mbi bibliotekat

P. Kosta, *Botuesit në ndihmë të punës së bibliotekarit*, "Buletini i bibliotekave", viti 1997, nr.1, fq. 17-18, vendndodhje: [Psh. 10 B].

R. Vozga, *Rëndësia e përfshirjes së Shqipërisë në projekt. Përvoja perëndimore dhe gjëndja e bibliotekave tona publike*, "Buletini i bibliotekave", v. 1997, nr.2, fq. 17 - 22, vendndodhje: [Psh. 10 B].

Rezolutë mbi zhvillimin e shërbimeve të bibliotekave publike shqiptare për komunitetin lokal, "Buletini i bibliotekave", v. 2002, nr.3, fq. 121 - 122, vendndodhje: [Psh. 10B]

Bibliotekat publike lokale janë pjesë e rrjetit të gjerë botëror të bibliotekave. Ato bashkëpunojnë ngusht me institucionet e tjera të kujtesës, me shkolla dhe institucione të tjera edukative. Këto biblioteka janë furnizuese kryesore të komunitetit me informacion dhe, si të thuash, janë specializuar për përballimin e nevojave për informacion të karakterit lokal. Bibliotekat publike mbështesin të gjitha llojet e arsimit, sigurojnë shfrytëzimin të trashëgimisë kulturore dhe të të gjithë informacionit të publikuar, mbështesin kulturën, identitetin dhe jetën sociale të rajonit ku funksionojnë. Shpesh në to shërbimi është i një standardi të lartë profesional që vjen si pasojë e gërshetimit të aftësive profesionale me vlerat etike dhe zotësitë profesionale të drejtuesve dhe punojësve të tyre. Epoka elektronike po krijon mundësi për biblioteka pa mure, ku njerezit mund të mësojnë në distancë ose mund të shfrytëzojnë informacionin që u duhet duke përdorur media elektronike. Në parim, roli i bibliotekave publike në Shoqërinë e sotme të Informacionit është pak a shumë i njëjtë me atë që ato kanë patur në Shoqërinë Industriale, pra, të grumbullojnë, të mirëmbajnë dhe të sigurojnë shfrytëzimin e informacionit dhe të njohurive të njerëzimit. Në praktikë, bibliotekat tona depozitojnë dhe shërbejnë vetëm fjalën e shkruar në letër. Kasetat, vidiokasetat, kompakt-disqet dhe mjete të tjera elektronike, nuk janë objekt i punës së tyre. Ka një kërkesë të dukshme për bibliotekat publike shqiptare për të ripërcaktuar detyrat e tyre, në qoftë se ato duan të mbijetojnë dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në kushtet e reja të shoqërisë së informacionit. Në Shqipëri, puna e bibliotekave publike duhet të fokusohet në një shtrirje më të madhe në mbështetje të jetës sociale. Komunitetet e qyteteve në të cilët këto biblioteka operojnë, kanë një numër të madh problemesh të rëndësishme sociale dhe ekonomike, që kanë të bëjnë me papunësinë, standardet e arsimit dhe fluksin e madh të popullsisë nga zonat rurale me pasoja për jetën e gjithë komunitetit. Bibliotekat publike shqiptare duhet të jenë të përgatitura të rivlerësojnë rolin dhe burimet e tyre, si dhe të rikonceptojnë shërbimet për t'iu përgjigjur kërkesave të shndërrimeve sociale. Këtu përfshihet edhe krijimi i shërbimeve të veçanta të informacionit për të mbështetur dhe përmirësuar veprimtaritë e biznesit lokal. Bibliotekat publike shqiptare duhet të shikojnë jo vetëm mundësinë e ngritjes së shërbimeve informuese për biznesin, por edhe të krijojnë marrëdhënie me komunitetin e biznesit. Kjo kërkon një strategji të qartë për zhvillimin e shërbimeve në mbështetje të ekonomisë lokale, veçanërisht të SME-ve.

Ashtu si edhe në vendet e tjera të rajonit, mund të renditen kështu vështirësitë nëpër të cilat kalojnë bibliotekat tona publike:

1. Mungesa e fondeve, e mjeteve të nevojshme monetare për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Është e vështirë dhe gati e pamundur të sigurosh një shërbim bibliotekar modern me fonde të kufizuara.
2. Mungesa e një shkollë për biblioteka në Shqipëri. Si formohen, si kualifikohen dhe si specializohen bibliotekaret tane?
3. Mungesa e një stafi të kualifikuar.
4. Sigurimi i mbështetjes politike. Mungesa e ndërjegjësimin të politikanëve për potencialin dhe rolin e bibliotekave publike është me pasoja të dëmshme për zhvillimin e tyre. Këta i shikojnë bibliotekat vetëm si kosto, si shpenzime dhe jo si investim. Ky qëndrim duhet të ndryshojë.
5. Një dobësi e punës së bibliotekave tona është edhe mosnjohja sa dhe si duhet e një aspekti të tillë të rëndësishëm të punës së tyre, që përmbledhet nën termin "marrëdhënie me publikun".
6. Është e rëndësishme të krijohen marrëdhënie të mira me zyrtarët, me ata që kanë në dorë mjete financiare ose sociale në dobi të zhvillimit të bibliotekave. Pavarësisht nga puna e mirë që mund të bëjë

një biblioteke, kjo s'ka shume vlerë në qoftë se askush nuk di gjë për këtë. Prandaj ka mjaft rëndësi dukja rregullisht në media dhe pergjithësisht të qenit vizibël.

7. Një problem tjetër për mbarëvajtjen e bibliotekave është edhe paraqitja jo e plotë e të dhënave nga ana e shtëpive botuese, gjë që pengon përgatitjen e informacionit për lexuesin.

Këto ishin disa nga problemet kryesore që ndeshen në bibliotekat tona.

[Treguesi](#)